

Thirrja është e hapur nga data 21.02.2024 deri më 28.02.2024

TERMAT E REFERENCËS

Ekspert/e për hartimin e Planit trevjeçar të punës (2024-2027) për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimin e punëtorise.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI
Objektiva	‘Hartimi i planit trevjeçar të punës (2024-2027) për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë e Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga Asambleja Komunale e Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe avokimi për hartimin dhe zbatimin e politikave lokale në favor të fëmijëve. Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit Nr. 251/23 të datës 07.04.2023, plotësim-ndryshimit të Vendimit Nr. 338/23 të datës 23.05.2023 dhe komfor Udhëzimit, Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për Themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, është formuar Ekipi për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Prizrenit. Komuna e Prizrenit është

zotuar që në afat sa ma të shkurtë do të hartojë Planin e Punës . Duke qenë pjesë e Ekipit komunal të Prizrenit, OJQ Nevo Koncepti ka shprehur interesim për të lehtësuar dhe mbështetur procesin e hartimit të Planit të Punës deri në momentin e aprovimit nga ana e Asamblesë Komunale të Prizrenit.

3. OBJEKTIVA

OJQ Nevo Koncepti, kërkon të angazhojë një ekspert/e për hartimin e Planit të Punës tre vjeçare (2024-2027) për Ekipin për të Drejtat e Fëmijës në komunën e Prizrenit, sipas Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022 për Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe Ligjit Nr. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS. Ekipi përbëhet nga dymbëdhjetë antarë, i cili është një trup komunal i themeluar sipas Ligjit nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili gjithashtu punon dhe angazhohet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, përmirësimin e mirëqenjes sociale, mbrojtjen nga dhuna dukuritë tjera që cenojnë të drejtat dhe interesin më të mirë të të gjithë fëmijëve në Komunën tonë. Prandaj, Nevo Koncepti është duke kërkuar një Ekspert/e për të mbështetur Ekipin për të Drejtat e Fëmijëve për të hartuar Planin e Punës së Ekipit, hartimi i planit trevjeçarë të punës për mbrojtjen e fëmijës siguronë që drejtat e fëmijëve të jenë të garantuara dhe të respektuara në pajtim me parimet themelore të të drejtave të fëmijëve sipas Konventës Ndërkombetare për të Drejtat e Fëmijës dhe Ligjit nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Diplomë Universitare (kualifikimi Master dhe edukimi profesional në fushat e arsimit, shkencave sociale apo juridike/joformal në fushën e të drejtave të fëmijëve, vendimmarrje dhe avokim/politika lokale është përparësi);
- Dokumentimi i përvojës së punës se paku pesë vjeçare në hartimin e planeve të punës që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve gjithëpërfshirjen dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje;
- Njohuri për parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në Konventën Ndërkombetare për të Drejtat e Fëmijës;
- Njohuri mbi mekanizmat dhe legjislacionin vendor në fushën e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve;
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike, udhëheqëse dhe shkathtësi në shkrim dhe komunikim me zyrtarë institucional dhe miqësore fëmijë;
- Shkathtësi të mira në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe;
- Përgatitja e planit të punës dhe metodologjisë, draft-agjendës dhe zhvillimin e materialeve të nevojshme për punëtorinë me Ekipin për të Drejtat e Fëmijës;
- Udhëheqja e punëtorisë dyditore me Ekipin për të Drejtat e Fëmijës dhe hartimin e draftit të parë të Planit të Punës tre vjeçar me rekomandimet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve/fëmijëve;

- Konsultimet me fëmijët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve-AKF pas hartimit të draftit të parë të planit të punës tre vjeçar dhe përfshirja dhe inkorporimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve të fëmijëve në plan;
- Dorëzimi i draftit të parë të planit të punës tek Nevo Koncepti, jo më vonë se shtatë (7) ditë pas mbajtjes së punëtorisë për rishikim nga Ekipi komunal për të Drejtat e Fëmijes të Prizrenit, Nevo Koncepti dhe Save the Children Kosova/o;

5. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me datën 29 Shkurt deri më 31 Mars 2024. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Familjarizimi me politikat zhvillimore komunale, legjislacionin në fuqi dhe Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Fëmijës, përgatitja e metodologjisë së punës për punëtori	Përgaditja e Matrialeve si: Metodologjia, agjenda dhe materialet tjera të nevojshme për hartimin e planit të punës.	2	Shkurt 2024
2	Mbajtja e punëtorisë për hartimin e planit të punës, përcaktimi i objektivave, rezultateve dhe aktiviteteve duke u bazuar në nevojat dhe propozimet që dalin nga vetë pjesëmarrësit	Ofrimi i punëtorisë 2-ditore për Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.	2	Mars 2024
3	Konsultimi me antarët e Asamblesë së Fëmijëve dhe finalizimi i Planit të Punës pas sugjerimeve nga grupet e interesit	Konsultimi me anëtarët e Asamblesë së Fëmijëve Prizren për sugjerime/ rekomandime.	1	Mars 2024
4	Përgatitja dhe dorëzimi i raportit narrativ		1	Mars 2024
	Gjithsej:		6	

6. REZULTATET E PRITSHME

- Zhvillimi i përmbajtjes së përgjithshme të planit të punëtorisë.
- Hartimi i Planit të Punës tre vjeçare (2024-2027) për Ekipin për të Drejtat e Fëmijës sipas Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022 për Funkcionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe Ligjit Nr. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS.
- Fëmijët-asambleistë të Asamblesë Komunale të Fëmijëve shprehin pikëpamjet e tyre dhe ato dëgjohen dhe përfshihen në dokumentin e Planit të Punës;
- Anëtarët e Ekipit komunal të Prizrenit për të Drejtat e Fëmijës dhe KK Prizren aprovon Planin e Punës tre vjeçare.
- Stafi i NVK dhe Save the Children Kosovo/a do të jenë të informuar lidhur me procesin e punëtorisë.

7. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet ti dërgojnë këto dokumente:

- 1) Metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e mbajtjes së punëtorisë dhe hartimin e Planit të Punës (2024-2027);
- 2) Një letër interesi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe eksperiencë në zhvillimin e planëve të punës për komuna dhe me theks të veçantë ku preket interesi më i mirë i fëmijës;
- 2) Diplomë Universitare që dëshmon kualifikimin e tij/saj;
- 3) Curriculum Vitae (CV);
- 4) Propozimi financiar*

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 28.02.2024** në e.qylangji@nevokoncepti.org duke e kopjuar (cc) në email o.osmani@nevokoncepti.org.